

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
RETAIL PARK SH.P.K.  
ME SELI NË : "RRUGA LUIGJ GURAKUQI, PALLATI 89, SHK.1, AP.33, TIRANË, SHQIPËRI  
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI  
L71515042Q**

---

**VENDIMI**

**I  
ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më 24.02.2021, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë "Retail Park" Sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në "Rruga Luigj Gurakuqi, pallati 89, shk.1, ap.33, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

1. "**Balfin-Balkan Finance Investment Group**" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kat 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("Ortaku i Vetëm").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Ada Gramatiku, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

**I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË RETAIL PARK SH.P.K.**

\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej 13,000,000 LEK (trembëdhjetë milion lekë), Financimi do të jepet në formën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 4,500,100 LEK (katër milion e pesë qind mijë e një qind lekë), do të zmadhohet në 17,500,100 LEK (shtatëmbëdhjetë milion e pesë qind mijë e një qind lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdeshshëm të çështjes së dyte në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

**VENDOSI**

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q) me 13,000,000 LEK (trembëdhjetë milion lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetem në para.

- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 4,500,100 LEK (katër milion e pesë qind mijë e një qind lekë) do të bëhet **17,500,100 LEK (shtatëmbëdhjetë milion e pesë qind mijë e një qind lekë).**
- D. Të autorizojë përdorimin e kapitalit të injektuar për investime të parashikuara nga Shoqëria.
- E. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjera për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

\*\*\*\*\*


**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË  
RETAIL PARK SH.P.K.**

**KRYETAR**

  
Edlira Muka  
 ZNJ. EDLIRA MUKA

**BALFIN**  
 Balkan Finance Investment Group

**SEKRETAR**

  
Ada Gramatiku  
 ZNJ. ADA GRAMATIKU